

PËRKTHIM JOZYRTAR

Vlerësim i pavarur formues i

Nismës së Ballkanit Perëndimor kundër Krimeve të Rënda (WBCSCI) në kontekstin e mekanizmit të Qeverisjes Integruese të Sigurisë së Brendshme, përfshirë këtu dhe veprimin e Bashkimit Evropian: “Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA II) Programi i Veprimit për Shumë Vende 2017- Mbështetje për Qeverisjen Integruese të Sigurisë së Brendshme të Ballkanit Perëndimor”

Ballkani Perëndimor

Ky vlerësim i pavarur u financua nga Bashkimi Evropian

Shkurt 2019



Ky raport vlerësimi i pavarur u përgatit nga një ekip vlerësues i përbërë nga: Punit Arora, Jim Newkirk, Peter Allan, Eleni Tsingou, Katherine Aston, dhe Emanuel Lohninger. Njësia e Pavarur e Vlerësimit (NjPV) e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet (UNODC) siguron instrumentet normative, udhërrëfyesit dhe formatet që duhen përdorur në procesin e vlerësimit të projekteve. Në faqen e internetit të NjPV-së mund të gjeni instrumentet përkatëse: <http://www.unodc.org/unodc/en/evaluation/evaluation.html>

Njësia e Pavarur e Vlerësimit (NjPV) e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet mund të kontaktohet në adresën e mëposhtme:

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet
Qendra Ndërkombëtare Vjenë
Kutia postare 500
1400 Vjenë, Austri
Nr. telefoni: (+43-1) 26060-0
email: unodc-ieu@un.org
Faqe interneti: www.unodc.org

Deklaratë për mos pranim përgjegjësie

Ky është një përkthim jozyrtar dhe nuk duhet të citohet. Ky dokument nuk ka si qëllim të përdoret për publikun e gjerë.

Këndvështrimet e shprehura në këtë raport të pavarur vlerësimi i përkasin njësisë së vlerësimit. Ato nuk përfaqësojnë këndvështrimet e UNODC-së ose të ndonjë institucioni apo Shteti Anëtar të referuar në këtë raport. Të gjitha gabimet dhe pasaktësitë janë përgjegjësi e njësisë së vlerësimit.

Meqenëse ky vlerësim financohet nga Bashkimi Evropian, të gjitha referencat në këtë dokument ndaj Kosovës* do të respektojnë përkatësisht vetëm referencën e BE-së: “* Ky përcaktim jepet pa paragjykim për qëndrimet mbi statusin, dhe në një vijë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr.1244/99, dhe Opinionin e GjND-së lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Të gjitha referencat ndaj Maqedonisë në këtë draft dokument duhet të interpretohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 817, paragrafi 2.

© Kombet e Bashkuara, Shkurt 2019. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk përfaqësojnë në asnjë mënyrë opinionet e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, qyteti, zone, apo të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve apo vijave kufitare të tij.

Botimit nuk i është bërë një rishikim zyrtar.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Konteksti

Në kontekstin e peizazhit penal të Ballkanit Perëndimor që po ndryshon dhe negociatave të juridiksioneve të ndryshme për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), rajoni është identifikuar të ketë mangësi në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar. Ndonëse natyra e krimeve moderne kërkon një qasje më të koordinuar dhe efikase për ta trajtuar atë, vihen re mangësi në mekanizmat rajonalë të bashkëpunimit dhe shembuj të identifikuar të dublikatave në asistencën teknike, si dhe mungesë e një drejtimi të përbashkët dhe koordinimin rajonal.

Kundër këtij konteksti, në vitin 2015 u ndërmor nisma e Ballkanit Perëndimor kundër Terrorizmit (WBCTi) për të përfaqësuar një qasje të përbashkët dhe të koordinuar të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor (WB). Kjo nismë, e mbështetur nga më shumë se 50 aktorë të rëndësishëm, si dhe nga Komisioni Evropian, synon integrimin e asistencës ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit. Më pas, ajo u zgjerua nga WBCTi në dy fusha të tjera të sigurimit të brendshëm: Nisma e Ballkanit Perëndimor kundër Krimeve të Rënda (WBCSCi) dhe Nisma e Ballkanit Perëndimor për Sigurimin e Kufijve (WBBSi) me mbështetjen e mekanizmit të Qeverisjes Integruese të Sigurisë së Brendshme (IISG). Koncepti i IISG-së u mbështet zyrtarisht nga Këshilli i BE-së në fund të vitit 2016, dhe nga Ministrat e Brendshëm/të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor në Procesin Brdo për Mbledhjen e Ministrave në shtator 2017. Mbështetja për Shumë Vende që ofron nisma e Qeverisjes Integruese të Sigurisë së Brendshme të Ballkanit Perëndimor (këtë e tutje referuar si 'Veprimi'), financuar nga Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA 2017), përqendrohet në disa boshllëqe madhore në ato fusha që përbëjnë sfidat më të vështira të rajonit. Ajo shihet si një instrument që thëllon bashkëpunimin mbi çështjet kryesore të politikave të jashtme dhe fuqizon drejtimin e BE-së në atë bashkëpunim.

Qëllimi, synimi dhe metodologjia

Ky vlerësim formues u ndërmor në një fazë të hershme gjatë procesit të zbatimit si një nismë e praktikës së mirë për caktimin e kufirit bazë për vlerësimet e ardhshme dhe për t'i integruar proceset e vlerësimit të kjo nismë. Ajo mbulon shtyllën e dytë të WBSCi/IISG-së lidhur me të gjithë IISG-në, përfshirë këtu veprimtarinë, rezultatet dhe produktet, si dhe strategjinë dhe strukturën e saj. Për më tepër, ajo mbulon dhe Veprimet e BE-së që i përkasin Shtyllës së II për periudhën maj 2016 deri në tetor 2018. Arritje në gjetje dhe përfundime të qenësishme mbi aspektet e Dizajnit, Rëndësisë, Efektivitetit, Efikasitetit, Ndikimit dhe Qëndrueshmërisë, Partneriteteve dhe bashkëpunimeve, dhe të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore të WBCSCi-së dhe Veprimit, vlerësimi i metodave të kombinuara të përdorura, qasje gjithëpërfshirëse dhe angazhuese.

Kufizime ndaj vlerësimit

Për arsye se WBCSCi-ja dhe Veprimi, dhe vetë IISG-ja, janë në hapat fillestarë, në këtë fazë ky vlerësim mund të ofrojë vetëm prova treguese. Për më tepër, qëllimi dhe kompleksiteti i operacioneve të përfshira në tre kategori të ndryshme (IISG, WBCSCi, Veprimi i BE-së) përbënin disa sfida unike për kryerjen e vlerësimit, gjë që njësia e

vlerësimet e ka adresuar duke shtrirë sa më shumë të ishte e mundur përpjekjen për mbledhjen e të dhënave.

Gjetjet kryesore

Dizajni: Sipas vlerësimit rezulton se IISG-ja mund të konsiderohet më mirë si një sipërmarrje në hapat e parë e cila ka identifikuar 'nevojat e sakta të klientëve', por prapë duhet të hartojë, krijojë dhe institucionalizojë sistemet dhe proceset zyrtare. Ndonëse strategjitë dhe politikat e WBCSCi-së dhe Veprimet janë të harmonizuara me çështjet e identifikuar në analizën e boshllëqeve mbi bashkëpunimin rajonal në luftën kundër krimeve të rënda dhe të organizuara, vihet re nevoja për të bërë prioritizim më të mirë të vetë përparësive, ndërkohë që merret parasysh dhe garantohet koherenca me nisma të tjera në rajon, në veçanti Veprimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor. Disa grupe të palëve të interesit u angazhuan intensivisht në hartimin e WBCSCi-së. Plani i Reagimit të Menjëhershëm, i hartuar nga IISG-ja, është një praktikë e mirë që inkorporon menaxhimin e rrezikut, shkëmbimin e informacioneve operacionale në kohë reale dhe ndërmarrjen e operacioneve të përbashkëta me përfshirjen e disa agjencive ligjzbatuese. Integrimi brenda kornizave të IISG-së të mbështetura në rezultate dhe përbërësve të ndryshëm të Veprimit është i pamjaftueshëm. Në përfundim, vlerësimet dhe konsideratat e të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore pranohen të jenë të rëndësishme, por përdorimi i tyre real në hartimin e ndërhyrjeve ka qenë relativisht i kufizuar.

Rëndësia: Rëndësia që ka WBCSCi-ja dhe Veprimet, dhe i tërë mekanizmi i IISG-së, për BE-në dhe palët e interesit në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht për qeveritë juridiksionale dhe proceset e tyre të anëtarësimit në BE, është mjaft e qartë gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe përmes konsultimeve me palët e interesit. Dokumentet strategjike mbështetëse të WBCSCi dhe Veprimi vërtetojnë rëndësinë e rajonit të Ballkanit Perëndimor në aspektet kryesore të mbuluara nga mekanizmi IISG-së duke përfshirë luftën kundër-terrorizmit, krimin të rëndë të organizuar dhe kontrollin kufitar. Ekziston një lidhje e ngushtë ndërmjet strategjive dhe prioriteteve të juridiksioneve përfituese dhe vëmendjes rajonale, sigurisë, anëtarësimit në BE dhe WBCSCi. Në nivel operacional, veçanërisht në lidhje me 'adresimin e kërcënimeve të sigurisë së brendshme të Ballkanit Perëndimor', nismat e WBCSCi-së përqendrohen në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve kombëtare për të menaxhuar kërcënimet ndaj sigurisë. Megjithatë, vëmendja e mekanizmit IISG në ndërtimin e bashkëpunimit të institucionalizuar ka pasur një lidhje disi më të dobët.

Efektiviteti: Aktivitetet dhe nismat që po vlerësohen janë në fazën fillestare të zbatimit, dhe si rrjedhojë, kontributi i tyre aktual në proceset e anëtarësimit në BE mbetet i kufizuar. Kështu, koncepti i IISG-së gjen një mbështetje të gjerë si një mjet me efektivitet të mundshëm për koordinimin/bashkëpunimin rajonal, por më pak mbështetje për nivelin aktual dhe qasjen ndaj zbatimit të mekanizmit. Megjithatë, puna e IISG-së është nxitja e bashkëpunimit jozyrtar dhe krijimi i besimit ndërmjet përfituesve në të gjithë rajonin. Gjithashtu, mbështetje e gjerë ofrohet për përmbajtjen dhe qasjen e nismave ekzistuese të Veprimit, përfshirë këtu punën me policinë, prokurorët, Ekipet e Vendosura në Shtetet përkatëse (ECT), Ekipet e Përbashkëta të Hetimit (JIT), hetuesit e krimin financiar, por është ende herët për të dhënë prova përfundimtare mbi efektivitetin e tyre.

Efikasiteti: Sipas të dhënave financiare, Grupi Mbështetës i IISG-së vepron me buxhet të kufizuar, por duket se kontribuon në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit joformal, duke pakësuar dublikatat dhe duke rritur efikasitetin e burimeve të përdorura

për të luftuar krimin e rëndë dhe të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Ndonëse është ende herët për të matur nivelin e efikasitetit, shembuj joformal të mbledhur sistematikisht theksojnë përmirësime në koordinim dhe pakësim të punëve të dublikuara (p.sh., trajnime), sipas dëshirës së donatorëve dhe palëve. Intervistat me palët e interesit ofruan disa shembuj të rëndësishëm, si p.sh. shmangia e planeve për të krijuar një rrjet të ri për Njësitë e Inteligjencës Financiare në Ballkanin Perëndimor pasi IISG-ja vuri në dukje ekzistencën e një rrjeti të tillë pranë një donatori të mundshëm. Palë të ndryshme interesi sugjeruan se konsultimet joformale midis donatorëve dhe ofruesve të asistencës teknike kanë rritur ndërgjegjësimin rreth projekteve aktuale, dhe si pasojë janë pakësuar përpjekjet e dyfishuara. Megjithatë, vlerësimi vuri në dukje mbivendosje të disa aktiviteteve si p.sh. dy trajnime mbi hetimet financiare që synonin të njëjtën audiencë, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Edhe pse pranonin që kishte ende dublikime të tilla, palët e interesit sugjeruan se do të ishte një objektiv më real pakësimi, në vend të uljes së këtyre dublikimeve.

Partneritetet dhe bashkëpunimet: Marrëveshja politike e nivelit të lartë midis anëtarëve të Bordit të IISG-së dhe qeverive përfituese nxjerr në dukje kontributin e IISG-së në krijimin e partneriteteve dhe bashkëpunimit. Megjithatë, IISG-ja nuk ka përcaktuar ende proceset përmes të cilave ajo identifikon partnerët përkatës për realizimin e qëllimeve të saj. Ekzistonte një dakordësi e përgjithshme midis palëve të interesit të intervistuar se partneriteti dhe bashkëpunimi i lehtësuar nga IISG-ja ka funksionuar edhe sa i përket Veprimit të BE-së dhe objektivave të para- aderimit lidhur me juridiksionet e Ballkanit Perëndimor. Shumë prej partnerëve të angazhuar me IISG-në vunë në dukje aksesin që IISG-ja i kishte ofruar partnerëve rajonalë si dhe institucioneve përkatëse të BE-së, dhe ekspertizën për të nxitur përpara progresin në këtë fushë. Megjithatë, reagimet nuk ishin shumë pozitive kur flitej rreth partneriteteve me donatorët, veçanërisht për Krerët e Delegacioneve të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile në rajon nxjerrin në pah një mungesë të angazhimit konkret me IISG.

Ndikimi dhe qëndrueshmëria: Për arsye se WBCSCi-ja ka qenë funksionale për rreth një vit, të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të arritur që të kuptohet nga gjetjet përfundimtare se cili ka qenë impakti afatgjatë në përmirësimin e sigurisë së përgjithshme në rajon (dhe Evropë), dhe as për të dhënë një ide reale të qëndrueshmërisë së vetë IISG-së ose nismave të IISG-së ose Veprimit të BE-së. Megjithatë, ka disa shembuj të mirë që tregojnë një rritje graduale drejt impakteve të mundshme të ardhshme, përfshirë dhe një qasje të Shteteve Anëtare të BE ndaj partnerëve rajonalë për krijimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit (JIT) dhe zhvillimit të vazhduar të rrjetit të prokurorëve. Jo vetëm që pati një ndikim të drejtpërdrejtë, si arrestimi i disa personave, por pati edhe një ndikim të papritur teksa partnerët e Ballkanit Perëndimor në Veprim u ndjenë ‘të përfshirë’ dhe pjesë e gjithë tablosë. Si përfundim, vlerësimi vë re se procesi i Aderimit në BE ofron mundësi dhe epërsi për t’i përqendruar veprimtaritë e përfituesve në fushat e Shtyllës së II drejt objektivit për të ulur krimin e rëndë dhe të organizuar në rajon dhe në Evropë. Në mënyrë të ngjashme, masat për asistencën për Aderimin në BE, dhe Aderimi në vetvete, janë korniza për qëndrueshmërinë politike dhe financiare të mekanizmit.

Përfundimet kryesore

Vlerësimi konstaton se ekipi drejtues i IISG-së identifikoi dhe synoi nevojën e duhur për të rritur koordinimin ose ndihmën teknike në Ballkanin Perëndimor. Ekipi drejtues luajti një rol largpamës në dhënien e ndihmës për të bashkuar palët kyçe të interesit dhe hodhi bazat për një reagim institucional më efikas dhe të efektshëm ndaj krimit të organizuar dhe të rëndë. Gjatë punës me një buxhet operacional të vogël, IISG-ja ka arritur të ofrojë “provën e konceptit” për “sipërmarrjen” e re. Megjithatë, menaxhimi i rritjes dhe arritja e

rezultateve, veçanërisht duke marrë parasysh ndryshimet e mundshme në drejtim në të ardhmen, do të kërkojë menaxhim më sistematik.

Ndonëse si instrument për veprimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, koncepti i IISG-së njihet gjerësisht si instrument me mundësi për të qenë i efektshëm për koordinimin rajonal, palët e interesit kanë mendime të kundërta për nivelin aktual të efektshmërisë. Megjithëse përfituesit janë përgjithësisht të kënaqur me konceptin dhe mbështetjen nga IISG-ja, palët e tjera të interesit po presin të shohin rezultate, veçanërisht në nivel operacional. Ndonëse IISG-ja po përdor Menaxhimin e Bazuar mbi Rezultate (MBR) për planifikimin e qëllimeve, as nuk është integruar mirë në dokumentet e tjera të planifikimit të IISG-së, as nuk ka një mbledhje sistematike të dhënash për monitorimin dhe vlerësimin. Kuadri i rezultateve të mirëpërcaktuara që integrohet më mirë në planifikimin e bazuar mbi rezultate të Veprimit mund t'i lehtësojë proceset mbi të cilat BE-ja, Grupi Mbështetës i IISG-së dhe përfituesit arrijnë dhe tregojnë rezultate nëpërmjet mekanizmit të IISG-së.

Ndonëse është shumë herët për të matur ndikimin në kontekstin e IISG-së dhe WBCSCi-së dhe Veprimit të BE-së, treguesve në kuadrin logjik iu mungon potenciali për të matur rezultatet afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra. Kjo ka rëndësi kur bëhet fjalë për matjen e ndikimit të mundshëm të trajnimit për trajtimin e krimeve të rënda dhe krimin të organizuar, meqenëse shumë nga veprimtaritë përqendrohen te ndërtimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve.

IISG-ja ka pasur sukses në zhvillimin e partneriteteve dhe bashkëpunimit me shumë aktorë kyç në rajon, duke përfshirë përfituesit dhe agjencitë ligjzbatuese. Megjithatë, partneritetet e tjera si me BE-në, OSHC-të dhe SELEC-un mund të përmirësohen dhe të zhvillohen më tej. Së fundi, ndonëse DCAF-ja ka qenë aktive në hedhjen e bazave dhe mundësimin e suksesit të IISG-së, ia vlen të rishqyrtojmë nëse vazhdon të jetë vendi i duhur për IISG-në. Kjo çështje duhet të përfshijë shqyrtimin e statusit të tij si organ i pavarur.

Rekomandimet kryesore

Grupi Mbështetës i IISG-së nxitet për të ngritur sisteme dhe procese menaxhimi më sistematike. Veç kësaj, duhet të qartësojë dhe të menaxhojë pritshmëritë e palëve të interesit për rezultatet, pasi duhet kohë për të ndërtuar infrastrukturën dhe proceset për koordinim të efektshëm. Grupi Mbështetës në konsultim me juridiksionet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për t'iu dhënë përparësi prioritetëve, edhe nëse kjo do të thotë se jo të gjitha grupet e palëve të interesit do të jenë krejtësisht të kënaqur me zgjedhjet strategjike. Krahas kësaj, Grupi Mbështetës duhet t'i rishikojë partnerët aktualë dhe të identifikojë se ku mund të forcohen partneritetet ekzistuese dhe ku mund të formohen partneritete të reja, duke përfshirë edhe OSHC-të në rajon. Duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një metodologji për hartëzimin e rregullt të veprimtarive në nivel vendi dhe nivel rajonal, që lidhen me të tri shtyllat për të minimizuar rrezikun e dyfishimit të veprimtarive kyçe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në bashkëpunim me drejtuesit e grupeve zbatuese të Veprimit të BE-së, nxitet për të angazhuar ndihmën teknike në një dizajn të bazuar mbi rezultate dhe kuadrin e menaxhimit për të forcuar lidhen midis logjikës së rezultateve në kuadrot e IISG-së.

Bordi i IISG-së nxitet të rishqyrtojë strukturën organizative, si dhe objektivat dhe mekanizmat e IISG-së, duke përfshirë pavarësinë strukturore dhe autonominë nga DCAF-ja për Grupin Mbështetës të IISG-së. Grupi Mbështetës i IISG-së, në konsultim të ngushtë me të gjitha palët përkatëse, duke përfshirë juridiksionin e Ballkanit Perëndimor, BE-në dhe Partnerët Drejtues, duhet të paraqesë një propozim të hollësishëm për t'u marrë në shqyrtim nga bordi.

Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe Grupi Mbështetës i IISG-së duhet të zhvillojnë dhe të pajtohen për udhëzime dhe pritshmëri të qarta mbi rezultatet dhe raportimin bashkë me axhendat e paracaktuara.

Mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira

Analiza e boshllëqeve e kryer nga drejtuesit e IISG-së për të kuptuar “nevojat e klientëve” për rritjen e koordinimit të ndihmës teknike në rajonin e Ballkanit Perëndimor përfaqëson praktikën më të mirë, që organizatat, projektet dhe programet e tjera duhet t'i riprodhojnë. Si rrjedhojë e shqyrtimit dhe kuptueshmërisë së thellë të këtij mjedisi, IISG-ja ka arritur të kuptojë dhe të adresojë “tregun” e tyre. Krahas kësaj, IISG-ja ka pasur sukses në fitimin e besimit të përfituesve dhe pranimin në nivel politik, çka përfaqëson praktikë të mirë. Një vlerësim formues në fazat e hershme të ngritjes së organizatës dhe mekanizmave tregon interes në kulturën e vlerësimit dhe të nxënies së organizimit, çka vlen të riprodhohet dhe të ruhet për një periudhë afatgjatë. Në lidhje me mësimet e nxjerra, nevoja për institucionalizim më të madh të sistemeve dhe proceseve të menaxhimit është e qartë. Vetë IISG-ja do të bënte më mirë të përqendrohej në këtë aspekt gjatë fazës së radhës.

PËRKTHIM JOZYR

MATRICA PËRMBLEDHËSE E GJETJEVE, PROVAVE DHE REKOMANDIMEVE

Gjetjet	Provat (burimet që mbështetin gjetjet)	Rekomandimet (zbatues)
<p>1. Drejtuesit e IISG-së identifikuan dhe synuan “nevojat e duhura të klientëve” për rritjen e koordinimit dhe ndihmës teknike në Ballkanin Perëndimor. Megjithëse ekipi drejtues i ka hedhur bazat për një reagim më efikas dhe të efektshëm, ato duhet të institucionalizohen më formalisht.</p>	<p>Intervista, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.</p>	<p>1) IISG-ja duhet të ngrejë sisteme dhe procese menaxhimi më sistematike për të kaluar nga një biznes i ri në një institucion më serioz. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së)</p>
<p>2. Koncepti i IISG-së njihet gjerësisht si një instrument me mundësi për të qenë i efektshëm për koordinimin rajonal, por palët e interesit kanë mendime të kundërta për nivelin e tij aktual të efektshmërisë. Ndonëse shumë palë interesi janë të kënaqura me konceptin e IISG-së, të tjerët po presin rezultatet.</p>	<p>Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.</p>	<p>2) IISG-ja duhet të qartësojë dhe të menaxhojë pritshmëritë e palëve të interesit për rezultatet, pasi duhet kohë për të krijuar infrastrukturën dhe proceset për koordinim të efektshëm. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së)</p>
<p>3. Ndonëse DCAF-ja ka luajtur një rol tejet të rëndësishëm në hedhjen e bazave të hershme dhe mundësimin e suksesit të IISG-së, ia vlen të shqyrtohet nëse vazhdon të jetë vendndodhja e duhur për Grupin Mbështetës të IISG-së. Kjo çështje duhet të përfshijë shqyrtimin e statusit të saj si organ i pavarur, si dhe të</p>	<p>Intervista, misione në terren dhe diskutime në fokus grupe.</p>	<p>3) IISG-ja nxitet të shqyrtojë edhe njëherë strukturën organizative dhe vendndodhjen gjeografike, si dhe objektivat dhe mekanizmat e IISG-së, përfshirë pavarësinë strukturore, për Grupin Mbështetës të IISG-së. Në konsultim me të gjitha palët përkatëse, Grupi Mbështetës i IISG-së duhet të zhvillojë dhe të ofrojë propozime të hollësishme për shqyrtim nga Bordi i IISG-së. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së; Bordi i IISG-së).</p>

vendndodhjes gjeografike.		
4. Vlerësimi konstaton se ndonëse ka qenë shumë e efektshme në përfshirjen e përfituesve, IISG-ja po merr më shumë përgjegjësi sesa mund të përballohen nga burimet e saj me efektshmëri.	Intervista, diskutime në fokus grupe, anketime, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	4) Në konsultim të ngushtë me juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, IISG-ja duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për t'iu dhënë përparësi prioriteteve. Krahas kësaj, duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një metodologji për hartëzimin e rregullt të të gjitha veprimtarive vendore dhe rajonale, në lidhje me të tri shtyllat për të lehtësuar planifikimin dhe për të minimizuar rrezikun e dyfishimit të veprimtarive kyçe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së; Bordi i IISG-së).
5. IISG-ja ka pasur sukses në zhvillimin e partneriteteve dhe bashkëpunimit me shumë aktorë kyç në rajon, duke përfshirë përfituesit dhe agjencitë ligjzbatuese. Krahas kësaj, ka arritur të pranohet në nivelin politik në rajon. Megjithatë, nuk ka procedura sistematike për identifikimin e partnerëve të mundshëm dhe partneritete të tjera, si: BE, SELEC dhe OSHC mund të përmirësohen/zhvillohen .	Intervista, diskutime në fokus grupe, anketime, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	5) IISG-ja duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një mekanizëm për rishikimin e efektshmërisë të partneriteteve të tij aktuale, përfshirë Delegacionet e BE-së dhe OSHC-të. Ky mekanizëm duhet të identifikojë më tej partneritetet e reja të mundshme dhe të shqyrtojë se si mund të përmirësohet partneriteti ndërshtyllor. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së; Bordi i IISG-së).
6. Ndonëse po përdor Menaxhimin e Bazuar mbi Rezultate (MBR) për qëllime planifikimi, IISG-ja nuk po mbledh sistematikisht të dhëna për monitorimin dhe vlerësimin. Integrimi më i mirë i kuadrove të rezultateve do të përmirësonte ndjeshëm aftësinë e partnerëve zbatues, Grupit Mbështetës të IISG-së, Shteteve Anëtare, përfituesve dhe BE-së për	Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	6) Grupi Mbështetës i IISG-së dhe drejtuesit e grupeve zbatuese të Veprimit të BE-së nxiten për të përfshirë ndihmën teknike në një kuadër dizajni dhe menaxhimi me bazë rezultatet për të forcuar lidhjen e logjikës së rezultateve në kuadrot IISG (kuadri logjik dhe iPA) dhe midis këtyre kuadrove dhe atyre të Veprimit të BE-së dhe kuadrove logjike të grupeve zbatuese të Veprimit. Qëllimi i kësaj nisme do të ishte të zhvillojnë një Teori gjithëpërfshirëse Ndryshimi për elementin WBCSi të IISG-së,

të diskutuar vlerën dhe efektshmërinë e IISG-së dhe WBCSCi-së. Një kuadër rezultatesh më i mirëpërcaktuar mund të lehtësojë proceset nëpërmjet të cilave BE-ja, Grupi Mbështetës i IISG-së dhe Shtetet Anëtare arrijnë rezultate më të mira nëpërmjet mekanizmit IISG.		duke përfshirë të gjitha aspektet e Veprimit të BE-së, dhe nëpërmjet kësaj Teorie Ndryshimi të kenë një instrument të vetëm integruar për punën e të gjithë këtyre aktorëve. (Veprim:Grupi Mbështetës i IISG-së, partnerët zbatues të Veprimit të BE-së, Bordi i IISG-së).
7. Qëndrueshmëria e mekanizmit të IISG-sëvaret nga niveli i pronësisë i treguar nga juridiksionet e përfituesve, që punon nëpërmjet mekanizmit të Bordit të IISG-së.	Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	7)IISG-ja duhet të përmirësojë rolin, përfshirjen dhe pronësinë e mekanizmit të IISG-së për juridiksionet e përfituesve, që punon nëpërmjet mekanizmit të Bordit të IISG-së. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së, Bordi i IISG-së).
8.Ndonëse është ende herët për të matur ndikimin në kontekstin e IISG-së dheWBCSCi-së dhe Veprimit të BE-së, treguesit në kuadrin logjik nuk kanë potencialin për të matur rezultatet afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra.	Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	8)IISG-ja duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për mbledhjen sistematike të të dhënave për monitorimin dhe vlerësimin. Krahas kësaj, treguesit e matjes së ndikimit të ardhshëm të IISG-së dhe Veprimit të BE-së duhet të ripunohen në përputhje me kuadrot strategjike përkatëse. (Veprim:Grupi Mbështetës i IISG-së).
9. Në përgjithësi, konsideratat eHRGE-së pranohen të jenë të rëndësishme, por përdorimi i tyre faktik nëhartimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve deri tani kanë qenë disi të kufizuara.	Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	9)IISG-ja duhet të përdorë më qartazikonsideratat për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore gjatë punës me partnerët zbatues për ndërhyrjet në hartim dhe zbatim. Kjo do të ndihmonte në garantimin se vëmendja e synuar mbi HRGE-në është përqendrim konkret mbi zbatimin. (Veprim: Grupi Mbështetës i IISG-së)
10. Vlerësimi gjen nevojën për përmirësime në menaxhimin e IISG-së për marrëdhënien me donatorët madhorë, sidomos në lidhje me raportimin dhe pritshmëritë e rezultateve.	Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe shqyrtim dokumentacioni.	10) Bashkimi Evropian dhe përfaqësuesit e IISG-së duhet të zhvillojnë dhe të pajtohen mbi udhëzime dhe pritshmëri të qarta për rezultatet dhe pritshmëritë e raportimit bashkë me axhendat e paracaktuara. (Veprim: Bashkimi Evropian, Grupi Mbështetës i IISG-së).
11. Planifikimi, koordinimi dhe zbatimi në Veprimin e BE-së duhet të bashkërendohen më mirë.	Intervista, diskutime në fokus grupe, misione në terren dhe	11) BE-ja ka nevojë për një teori ndryshimi të qartë dhe të përbashkët me të gjithë zbatuesit e Veprimit të BE-së në bord për planifikimin dhe koordinimin. Ata

	shqyrtim dokumentacioni.	duhet të kenë kontribute të qarta dhe të paracaktuara për të ndikuar dhe për të rezultuar te synimet. (Veprimi: Bashkimi Evropian).
--	--------------------------	---

PËRKËTHIM JOZYRTAR